



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF  
KOSOVO  
**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik  
Zyra e Kryetarit



01Nr.400 01-16234/25

Kaçanik, 23.07.2025

Procesverbal nga Konsultimi buxhetor për projekt buxhetin 2026-2027 sektorin e bujqesise

Vendi: Salla e Kuvendit Kaçanik

Ora 11:00

Data: 23.07.2025

Në vazhdimësinë e konsultimeve publike buxhetore përritjen e transparencës dhe gjithpërfshirjes komunale, u organizua konsultim buxhetor me sektorin e bujqësisë.

Në fjalën e tij Nënkyetari i Komunës Sabedin Vishi tha se edhe ky takim po organizohet në vazhdën e konsultimeve buxhetore, ndërsa shtoi se këto takime po organizohen përritje dëgjuar kërkesat e qytetarëve dhe më pas në bazë të mundësive të inkorporohen në buxhetin komunal. Nënkyetari tha se në sektorin e bujqësisë janë tejkaluar shifrat që kanë qenë përemtuara nga Kryetari Ilazi përkohës, ku kanë qenë përemtuara 300 mijë euro, ndërsa ka arritur shuma e subvencioneve në bujqësi afér 1 milion euro, duke bashkëpunuar edhe me organizata ndërkombëtare. Nënkyetari tha se pas rregullimit të kanaleve të ujitjes, vitin tjetër do të investohet në rregullimin e rrugëve fushore përtokat bujqësore. Në takim prezantoi edhe drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Suhad Dullovi, i cili falenderoi fermerët përpjekjet e përgatitjeve si dhe përpjekjet e punës së angazhimit e tyre të palodhur në punët e bujqësisë. Të pranishmit në takim përkrahën idenë përritje rregullimin e rrugëve fushore, ndërsa kërkuan ulje të kritereve përsëri subvencione komunale, subvencionim të fermerëve përlitë qumështi, subvencionim të pompave të ujitjes, trajnime përfshirë nga ekspertët e fushës, të përkrahen fermerët që shumëfishtojnë subvencionet dhe që punojnë me përkushtim etj.

**Fadil Vishi**- Administrator i fshatit Dubravë- Jemi mirënjohës përkrahjen komunale, subvencionet janë të pamjaftueshme përritje funksionuar mirë, përkrahim idenë e rregullimit të rrugëve fushore, përfshirë se makineritë në bujqësi janë të mëdha dhe shpesh kemi probleme që ato makineri të depërtojnë në vende të caktuara, por poashtu ende ka nevojë përkrahjen përfshirë kanale të ujitjes, të subvencionohen lagjet ose fshatrat me pompa të ujitjes përritje bujqësi.

**Shefket Salijaj-** Me mundësi të hapen puse, hapja e rrugëve fushore është shumë e nevojshme, kombanjerët e rinj nuk kan mundur të depërtojnë.

**Nuhi Mema-** të ulen kriteret për përfitimet e subvencioneve, unë posedoj lopë, por tokat i marr me qera. Janë pak fermer që merren me lopë dhe përpunim të qumështit, andaj kërkoj që këta fermer të subvencionohen me një shumë të caktuar për litër.

**Ibush Vishi-** kanë qenë përfitues i subvencioneve për arra, por e kam shumëfishuar subvencionimin, ka mungesë të ujitjes, të përkrahen bujqit që i shumëfishojnë subvencionet.

**Shemsi Luzha-** fermer bletar- Kemi fjalë të mira për stafin e drejtorisë së bujqësisë, jemi subvencionu me koshere dhe makineri ju bëj thirrje për trajnime të fermerëve në fusha të ndryshme nga ekspert të lëmisë së caktuar.

Të gjithë ata që parashtruan kërkesat e tyre morën përgjigje në mënyrë të përgjithshme nga Nënkyetari i Komunës dhe stafi i drejtorisë, ndërsa ditëve në vijim do të përgatitet edhe raporti me të gjitha përgjigjet për secilën kërkesë.

Takimi përfundoi në ora 14:10.

#### Procesmbajtëse

